



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 536/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.08.2019, shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Colombo” sh.p.k. & “Ndërtimi” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-19858-04-26-2019, me objekt: “*Ndërtim kopeshiti me dreke ne fshatin Cerme Sektor, Njesia Administrative Terbuf, Bashkia Divjakë*”, me fond limit 56.051.653 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë”.
- Ankimues:** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Colombo” sh.p.k. & “Ndërtimi” sh.p.k.
Lagjja “Kryengritja e Fierit”, Rruga “Vangjel Rrushku”, Fier
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Divjakë
Lagjia nr. 2, Divjakë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.04.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-19858-04-26-2019, me objekt: “*Ndertim kopeshti me dreke ne fshatin Cerme Sektor, Njesia Administrative Terbuf, Bashkia Divjakë*”, me fond limit 56.051.653 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 07.06.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Avduli” sh.p.k.
& “Bahas” sh.p.k. 39.608.860 lekë, skualifikuar
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Colombo” sh.p.k.
& “Ndertimi” sh.p.k. 40.015.537 lekë, skualifikuar

- | | |
|--|-----------------------------------|
| 3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Llazo” sh.p.k.
& ”Viante Konstruksion” sh.p.k. | 40.090.140 lekë, kualifikuar |
| 4. “Shendelli” sh.p.k. | 41.214.360 lekë, skualifikuar |
| 5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Mf Invest Group” sh.p.k.
& “A.L-Asfalt” sh.p.k. & “Mane/S” sh.p.k. | 41.717.380 lekë, kualifikuar |
| 6. “Company Riviera 2008” sh.p.k. | 44.068.327 lekë, kualifikuar |
| 7. “Agi Kons” sh.p.k. | 44.772.850 lekë, kualifikuar |
| 8. “Vllaznia Ndertimi I.S” sh.p.k. | 47.396.520 lekë, kualifikuar |
| 9. “Leon Konstruksion” sh.p.k. | 47.522.607 lekë, kualifikuar |
| 10. “Aurora Konstruksion” sh.p.k. | 47.615.200 lekë, kualifikuar |
| 11. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “T& T Beton” sh.p.k.
& “Vellezerit Hysa” sh.p.k. | 47.640.528 lekë, kualifikuar |
| 12. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B-93” sh.p.k.
& “Arkonstudio” sh.p.k. | 47.648.147 lekë, skualifikuar |
| 13. “Zdravo” sh.p.k. | 48.944.966 lekë, kualifikuar |
| 14. “Sireta 2F” sh.p.k. | 51.555.555 lekë, kualifikuar |
| 15. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “2Z Konstruksion” sh.p.k.
& “G.P.G Company” sh.p.k. | 55.132.360 lekë, kualifikuar |
| 16. “Elda-VI” sh.p.k. | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.3. Në datën 20.06.2019 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Colombo” sh.p.k. & “Ndertimi” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyet si më poshtë vijon:

- *Preventivi i ndarjes se punimeve, si pjese integrale e kontrates se bashkepunimit te shoqerise “COLOMBO” Shpk dhe “NDERTIMI” Shpk, nuk eshte paraqitur me vula lidhese noteriale.*
- *Nuk eshte paraqitur dokumentacioni i duhur i kerkuar per mjetin: Pompe thithese uji (Icope), sic eshte kerkuar ne DST.*
- *Ne deklaraten per drejtuesin teknik te punimeve, te paraqitur nga shoqeria “COLOMBO” Shpk, pasi u bene verifikimet e nevojshme, rezulton se nuk permbush kriterin per pervojen e punes prej 5 vjet.*

II.4. Në datën 26.06.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, ku kundërshton skualifikimin e ofertës së tij.

Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon se:

[...] Në datën 07.06.2019, Ak Bashkia Divjakë zhvilloi Proçedurën e Hapur të Prokurimit me objekt: Ndërtim kopshti me dreqë në fshatin Çermë Sektor, Njësia Administrative Tërbuf, Bashkia Divjakë me fond limit 56 051 653 (pesëdhjetë e gjashtë million e pesëdhjetë e një mijë e gjatëqind

e pesëdhjetë e tre) lekë pa tvsh, ku shoqëria COLOMBO sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar dhe ofertën e saj.

Oferta ekonomike e ofertuar prej shoqërisë tonë për kryerjen e punimeve ishte në vlerën 40015537.00 lekë.

Në datën 20.06.2019 Ak njoftoi OE pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E) mbi rezultatet e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nga ku rezulton se shoqëria COLOMBO sh.p.k është e skualifikuar me arsyet:

“ – Preventivi i ndarjes së punimeve, si pjesë integrale e kontratës së bashkëpunimit të shoqërisë “COLOMBO” sh.p.k dhe “NDERTIMI” sh.p.k nuk është paraqitur me vula lidhëse noteriale.”

-Nuk është paraqitur dokumentacioni i duhur i kërkuar për mjetin: pomp thithëse uji (1 copë) siç është kërkuar në DST.

– Në deklaratën për drejtuesin teknik të punimeve të paraqitur nga shoqëria COLOMBO sh.p.k, pasi u bënë verifikimet e nevojshme, rezulton se nuk përmbushin kriterin për përvojën e punës prej 5 vjet”.

Sa më sipër kundërshtojmë skualifikimin e shoqërisë sonë me argumentet si më poshtë:

Në lidhje me arsyen “Nuk është paraqitur dokumentacioni i duhur i kërkuar për mjetin: Pompë thithëse uji (1 copë), siç është kërkuar në DST.

Referuar DST, përkatësisht pika:

f. Disponim i Mjeteve dhe Makinerive

Dëshmi për mjetet e paisje teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor OE, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës: ndër të tjera është kërkuar

Pompë thithëse uji	Copë	1	Pronësi ose qera
--------------------	------	---	------------------

Për mjetet dhe paisjet e tjera që nuk janë të shënuara në regjistra publike, duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat teknike, të paraqitet dokument i vlefshëm që vërteton pronësinë apo marrjen me qira të tyre, shoqëruar me dokumentat pronësisë të qiradhënësit,

Sqarojmë: Për të plotësuar kërkesën e mësipërme, Shoqëria “COLOMBO” sh.p.k ka paraqitur në sistem dokumentacionin që vërteton pronësinë e mjetit:

Fatur Tvsh-je: Nr.E148 dt 31.01.2017, sasia 2 copë

Nr.E903 dt 26.06.2017, sasia 1 copë, të shoqëruara dhe me foto

Si dhe shoqëria “NDERTIMI” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin fatur Tvsh-je: Nr.828 dt 02.06.2015, sasia 3 copë, të cilat përmbushin kërkesën e bërë nga ana juaj.

Pretendimi juaj se nuk është paraqitur dokumentacioni i duhur është absurd pasi për të vërtetuar pronësinë e tyre janë paraqitur fatura tvsh-je sipas legjislacionot.

Sa më sipër pretendimi juaj nuk mund të pranohet nga ana jonë pasi është i pabazë dhe aspak ligjor dhe i qëllimshëm.

Në lidhje me arsyen “Në deklaratën për drejtuesin teknik të punimeve, të paraqitur nga shoqëria “COLOMBO” sh.p.k, pasi u bënë verifikimet e nevojshme, rezulton se nuk përmbush kriterin për përvojën e punës prej 5 vjet.”

Referuar DST, përkatësisht pika dh: Kandidati ofertues duhet të paraqesë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt dhe të deklarojë se ai do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe duhet të ketë përvojë pune prej 5 vjet. Për drejtuesin teknik të punimeve në objekt duhet të ketë dokumentacionin e mëposhtëm:

Kontratë pune (përkatëse)

Diplomë (përkatëse)

Librezë pune (përkatëse)

CV (përkatëse)

Sqarojmë: Për plotësimin e kërkesës së mësipërme, shoqëria “COLOMBO” sh.p.k ka paraqitur në system dokumentacionin me emrin e File-it COLOMBO DREJTUES TEKNIK, ku ka deklaruar Drejtues Teknik të objektit Ing.Ndërtimi Vasil Kosta dhe Ing.Ndërtimi Ardian Seramati. Referuar dokumentacionit të paraqitur për të dy inxhinierët përkatësisht për Ing. Vasil Kosta (Kontratë pune, Diplomë, Librezë pune, CV) diplomuar në Universitetin e Tiranës në vitin 1978 me diplomë Nr.3926 vërtetohet jo eksperiencë 5 vjeçare por 41 vjeçare, nuk arrijmë të kuptojmë se ku bazoheni ju në pretendimin tuaj për eksperiencën më pak se 5 vjet.

Gjithashtu referuar diplomës së Ing.Ardian Seramati, i cili ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 2010, me eksperiencë 9 vjeçare, dhe ky inxhinier e përmbush kërkesën tuaj për eksperiencën 5 vjeçare.

Sa më sipër është mëse e qartë që të dy inxhinierët e përmbushin kriterin e vendosur nga na juaj në DST për eksperiencën 5 vjeçare, madje të dy inxhinierët kanë një eksperiencë pune shumë herë më të kërkuar nga ana juaj. Pretendimi juaj është absurd dhe I pabazuar në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria “COLOMBO” sh.p.k si dhe I tillë nuk mund të pranohet nga ana jonë.

Në lidhje: Preventivi i ndarjes së punimeve, si pjesë integrale e kontratës së bashkëpunimit të shoqërisë “COLOMBO” sh.p.k dhe “NDERTIMI” sh.p.k nuk është paraqitur vula lidhëse noteriale”

Sqarim: Bazuar në nenin 74 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 [...]

Nga ana jonë është paraqitur Kontrata e Bashkëpunimit e lidhur pranë Noterit, në të cilën është përcaktuar përqindja e pjesëmarrjes për të dy anëtarët.

Gjithashtu kemi paraqitur Preventivin e ndarjes së Punimeve, i cili është plotësisht në rregull, i firmosur dhe vulosur nga të anëtarët e bashkëpunimit, ashtu si çdo dokumentacion tjetër i paraqitur në këtë procedurë. Në kontratën e Bashkëpunimit të lidhur para noterin Neni 4 “Përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim të shoqërive”, Pika 4.1 është shprehur qartë përqindja që do të marrë përsipër të realizojë secili anëtar dhe në pikën 4.2 shprehet “Ndarja e detajuar e punëve sipas zërave do të jetë sipas preventivit të ndarjes së punimeve bashkëngjitur kontratës së bashkëpunimit”. Ndarja e punimeve sipas zërave nuk bëhet para noterit por vetëm midis anëtarëve, ndërsa përqindja e realizimit të punës nga secili anëtar është vendosur para noterin nëpërmjet Kontratës së Bashkëpunimit. Për më tepër në eksperiencën tonë disa vjeçare, ku paraqitja e ndarjes së punimeve është bërë në këtë mënyrë dhe nuk ka pasur asnjë kundërshtim nga ana e tyre, ju jeni i vetmi AK që nxjerr një pretendim të tillë, ku ndarja e punimeve sipas zërave të punës është shprehur në Kontratën e Bashkëpunimit se i bashkëlidhet kësaj kontrate.

Gjithë sa më sipër pretendimet tuaja nuk janë aspak ligjore, në bazë të LPP, por janë pretendime të sajura vetëm për të na skualifikuar, bashkimi i OE “COLOMBO” sh.p.k & “NDERTIMI” sh.p.k ka plotësuar të gjitha kërkesat e DST.

Përfundimish kërkojmë:

- 1. Pezullimin e procedurës dhe shqyrtimin e ankesës sone.*
- 2. Kualifikimin dhe shpalljes fitues të shoqërisë “COLOMBO” sh.p.k si oferta më ekonomike të paraqitur.*

II.5. Me shkresën nr. 2528/3 prot., datë 28.06.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke mos e pranuar ankesën, ndërkohë që operatori ekonomik ankimues pretendon se është njohur me kthim përgjigje në datën 03.07.2019.

Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes së ankesës argumenton se:

[...] përsa i përket pretendimeve tuaja në lidhje me drejtuesin teknik në objekt ju sqarojmë se afati 5 vjeçar i kërkuar si përvojë pune, i referohet punës pranë shoqërisë tuaj. Po ashtu kjo duhet të ishte deklaruar nga ana juaj në deklaratën e paraqitur për drejtuesin teknik siç është kërkuar në DST.

Në lidhje me pretendimet tuaja, përsa i përket dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i shoqërive “Colombo” shpk dhe “Ndërtimi” shpk për arsyen e skualifikimit për preventivin sqarojmë se tek neni 74 pika 2 e VKM 914, datë 29.12.2014 parashikohet se: [...]

Pra ndarja e detajuar e punëve sipas zërave do të jetë sipas preventivit të ndarjes së punimeve bashkëngjitur kontratës së bashkëpunimit. Në interpretim të kësaj dispozite, si edhe duke qenë se preventivi i ndarjes së punimeve duhet të jetë pjesë e kontratës së bashkëpunimit i gjithë dokumentacioni shoqërues i kontratës duhet të përmbajë vulë noteriale. Kjo bazuar edhe në dispozitat përkatëse të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. [...].

II.6. Në datën 05.07.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar skualifikimin e tij.

Konkretisht në ankesën e paraqitur pranë KPP-së operatori ekonomik ankimues argumenton duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

Në lidhje me kthimin e përgjigjes nga autoriteti kontraktor, operatori ekonomik ankimues argumenton se:

[...]

Në shkresën zyrtare 2528/3 prot datë 28.06.2019, në lidhje me mjetet AK Bashkia Divjakë nuk është shprehur për pretendimin për mjetet, çka do të thotë se ka pranuar ankesën e bërë nga ana jonë në lidhje me këtë pikë.

Autoriteti kontraktor ka kërkuar në DST drejtues teknik me përvojë pune 5 vjet dhe jo Drejtues teknik me përvojë pune 5 vjet pranë kompanisë.

AK ka vendosur mospranimin e ankesës sonë duke pretenduar se eksperiencia 5 vjeçare e shprehur në DST i referohet eksperiencës së drejtuesve teknik të objektit pranë shoqërisë sonë, një pretendim absolutisht absurd pasi drejtuesit teknik të një shoqërie mund të ndryshohen dhe në këtë mënyrë sipas AK i bie që një firmë që ka bërë ndryshime të drejtuesve teknik në 5 vitet e fundit të penalizohet nga pjesëmarrja në këtë procedurë çka bie në kundërshtim me lpp.

Shoqëria jonë ka një eksperiencë mbi 27 vjeçare në fushën e ndërtimit dhe pjesëmarrjen e procedurave të prokurimit publik dhe gjatë gjithë kësaj periudhe stafi i drejtuesve teknik është ndryshuar herë pas herë me qëllimin përmirësimin e kapacitetit profesional të firmës. Inxhinierët aktual pjesë e stafit drejtues teknik të shoqërisë sonë kanë një eksperiencë pune profesionale disa vjeçare çka përmbush qëllimin e AK për realizimin me sukses të kësaj kontrate.

[...]

Pretendimi i AK që duhet të jetë me vulë lidhëse noteriale kontrata e bashkëpunimit nuk përbën aspak një argument ligjor pasi noteri nuk mund të noterizojë ndarjen e punimeve pasi nuk është specialist i fushës të gjykojë ndarjen e punimeve sipas zërave pra pretendimi i AK është i pabazë dhe absurd.

Me shkresën zyrtare 2528/3 prot. datë 28.06.2019 AK këmbëngul në pretendimin se preventivi i ndarjes së punimeve duhet të bashkëlidhet me kontratën e bashkëpunimit me vulë noteriale çka nuk mund të pranohet nga ana jonë pasi ky preventiv është plotësisht në rregull, i firmosur dhe vulosur nga palët në bazë të përqindjes së vendosur në kontratën e bashkëpunimit të lidhur pranë noterit. Pra dokumentacioni që provon bashkëpunimin dhe ndarjen e punëve midis anëtarëve i paraqitur nga BOE përmban të gjithë elementët ligjor dhe është paraqitur në mënyrë të saktë nga ana jonë”.

II.7. Në datën 22.07.2019, nëpërmjet shkresës me nr. 2728/1 prot., datë 16.07.2019, me objekt: “Dërgim informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se arsyeja e skualifikimit “Preventivi i ndarjes së punimeve, si pjese integrale e kontrates së bashkëpunimit të shoqërisë “COLOMBO” Shpk dhe “NDERTIMI” Shpk, nuk është paraqitur me vula lidhëse noteriale”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në sistemin e prokurimeve elektronike, nga ana e autoritetit kontraktor janë publikuar dokumentat e tenderit si edhe shtojca për modifikimin e dokumentave, ku konstatohet se është publikuar edhe preventivi me zërat konkretë të punimeve që do të kryhen.

III.1.2. Në dokumentat e tenderit në shtojcën 12 është përcaktuar: *“Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:*

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme”.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se është paraqitur si më poshtë vijon:

- Kontratë bashkëpunimi për tender (bashkim i përkohshëm i dy shoqërive), me nr. Repertori 1202, koleksioni nr. 884, më datë 06.06.2019, ndërmjet shoqërisë “Ndërtimi” sh.p.k. dhe shoqërisë “Colombo” sh.p.k., me objekt “Ndërtim kopështi me drekë në fshatin Çermë Sektor, Njësia Administrative Tërbuf, Bashkia Divjakë”.

Në këtë kontratë bashkëpunimi në nenin 4 të saj “Përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunimin e shoqërive”, është përcaktuar se:

4.1 “Pjesëmarrja e kompanive në këtë bashkëpunim shoqërisht do të jetë sipas përqindjes së mëposhtme:

- ❖ *Shoqëria “Colombo” sh.p.k. do të mbulojë 90% të angazhimit të kontratës me autoritetin kontraktor;*
- ❖ *Shoqëria “Ndërtimi” sh.p.k. do të mbulojë 10% të angazhimit të kontratës kryesore me autoritetin kontraktor.*

4.2. Ndarja e detajuar e punëve sipas zërave do të jetë sipas preventivit të ndarjes së punimeve Bashkëngjitur kontratës së bashkëpunimit.

- Bashkëngjitur kontratës së bashkëpunimit është edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, ku deklarohet se përfaqësuesi i këtij bashkëpunimi të shoqërive do të jetë shoqëria “Colombo” sh.p.k.
- Gjithashtu konstatohet së në sistemin e prokurimeve elektronike është paraqitur dokumenti me emërtimin Preventivi.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

III.1.5. Në nenin 53, pika 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.1.6. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës.*

Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”,* ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.1.7. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.1.8. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: *“[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]”.*

III.1.9. Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë, në mbështetje të legjislacionit si më sipër cituar, është paraqitur vetëm kontrata e bashkëpunimit dhe prokura e posaçme dhe nuk është paraqitur bashkëngjitur këtij dokumenti të hartuar para noterit edhe preventivi/ndarja e zërave të punimeve të marra përsipër për t’u kryer nga secili anëtar i këtij bashkimi operatorësh ekonomikë, në respekt të legjislacionit në fuqi si më sipër cituar, si edhe nenit 4 të kontratës së bashkëpunimit të hartuar ndërmjet dy operatorëve ekonomikë anëtarë të këtij bashkimi operatorësh. Sqarojmë se bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar qartësisht që para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës.

Në kuptim të sa më sipër, në marrëveshjen e noterizuar duhet të përcaktohet përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit, si edhe elementët konkretë që do të kryejë secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Pra, marrëveshja e noterizuar, që të konsiderohet e saktë e në përputhje me legjislacionin në fuqi, përbëhet nga disa të dhëna, një prej të cilave është edhe përcaktimi i elementëve konkretë të zërave të punëve që do të kryhet nga secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë, pra elementët konkretë duhet të jenë të përcaktuar në marrëveshjen e noterizuar (të detajuar e përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit, si pjesë e neneve të saj në vijim ose pjesë integrale e saj), mjafton që të jetë në marrëveshjen e noterizuar, fakt ky i cili është përcaktuar edhe në nenin 4 të kontratës së bashkëpunimit nga ana e vetë operatorëve ekonomikë “Colombo” sh.p.k. dhe “Ndërtimi” sh.p.k., ku shprehet qartësisht se: *“Ndarja e detajuar e punëve sipas zërave do të jetë sipas preventivit të ndarjes së punimeve Bashkëngjitur kontratës së bashkëpunimit”*, ndërkohë që kjo ndarje e detajuar mungon dhe nuk është pjesë integrale ose e shprehur, në marrëveshjen e noterizuar të bashkëpunimit.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në marrëveshjen e bashkëpunimit, ashtu siç edhe përcaktohet në legjislacionin në fuqi, përpara noterit, përcaktohen të gjitha të dhënat sic janë përqindja e bashkëpunimit si edhe zërat/elementët konkretë që do të marrë përsipër për të kryer secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i është pranuar një prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori nuk do të ndryshojë, por do mbetet i skualifikuar në procedurën e prokurimit në fjalë, e përrjedhë duke mos përmbushur interes e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Colombo” sh.p.k. & “Ndërtimi” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-19858-04-26-2019, me objekt: “*Ndertim kopeshti me dreke ne fshatin Cerme Sektor, Njesia Administrative Terbuf, Bashkia Divjakë*”, me fond limit 56.051.653 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1209 Protokolli

Datë 05.07.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar	Anëtar	Anëtar
Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha